



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 958/2 prot.

Tiranë, më 30.04.2025

VENDIM

Nr. 08, datë 30.04.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 958 prot., datë 11.03.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me anë të kërkesës datë 03.02.2025, depozituar nëpërmjet shërbimit postar pranë Autoritetit Publik, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Vendimin nr. 2782, datë 12.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*
2. *Akt-Ekspertimin (Topografik) me nr. Akti 792, datë 27.06.2012.*

Autoriteti Publik nëpërmjet shkresës “kthim përgjigje”, datë 07.03.2025, ka kthyer përgjigje ankuesit duke e sqaruar se: “*...nga verifikimet e kryera nuk rezulton të jeni pjesë e këtij procesi gjyqësor dhe në këto kushte nuk mundt t’ju vihen në dispozicion aktet e sipërcituara...*”.

Ankuesja, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 958 prot., datë 11.03.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 958/1 Prot., datë 13.03.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me vendime të shpallura nga gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “*Autoritet publik*” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”. Në kuptim të këtij parashikimi, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë është vetë ky autoritet që detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: “1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Nga përgjigja e kthyer nëpërmjet shkresës “kthim përgjigje”, datë 07.03.2025, Autoriteti Publik refuzon vendosjen në dispozicion të ankueses, vendimin e shpallur nga kjo gjykatë, me pretendimin se kërkuësja nuk është palë në procesin gjyqësor dhe si pasojë nuk mund t’i vihen në dispozicion aktet.

Komisioneri vlerëson se, refuzimi i mësipërm i Autoritetit Publik, është i pa bazuar në ligj. Neni 146 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon shprehimisht në pikën 2 të tij se: “*Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast*”.

Për sa me sipër Autoriteti Publik, në shqyrtimin e kërkesës për informim të ankueses, duhet të kishte marrë parasysh vetëm parashikimet e pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuësit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”. Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara më sipër sipas pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr.15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave

personale në sistemin gjyqësor”, duke vendosur në dispozicion ato materiale mbi të cilat nuk ka një shkak ligjor për kufizimin.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. _____, nr. 958 prot., datë 11.03.2025, ndaj Autoritetit Publik, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 08.11.2024, konkretisht: *“1. Vendimin nr. 2782, datë 12.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë 2. Akt-Ekspertimin (Topografik) me nr. Akti 792, datë 27.06.2012.”*, brenda datës 08.04.2025.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 30.04.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi